



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 289/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.05.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF- 42437-01-26-2018, me objekt “Blerje mjete didaktike dhe kancelarike në funksion të projektit “Bëjmë detyrat e shtëpisë” dhe mjete kancelarike për nevojat e QEZHEF” me fond limit 2.004.271 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 20.02.2018 nga autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë.

Ankimues:

“Infosoft Office” shpk
Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, km 8, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë.
Adresa: Rruga “Barrikadave”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.01.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF- 42437-01-26-2018, me objekt “Blerje mjete didaktike dhe kancelarike në funksion të projektit “Bëjmë detyrat e shtëpisë” dhe mjete kancelarike për nevojat e QEZHEF” me fond limit 2.004.271 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 20.02.2018 nga autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 20.02.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 26.02.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Euro Office” shpk	Pa dokumentacion	skualifikuar
2. “Bizhga – 1” shpk	Pa dokumentacion	skualifikuar
3. “Paera” shpk	Pa ofertë	skualifikuar
4. “Adastra” shpk	1,494,000 lekë	skualifikuar
5. “InfoSoft Office” shpk	1,573,730.95 lekë	skualifikuar

6. "PC Store" shpk

1,982,350 lekë

skualifikuar

II.3.1. Në datë 26.02.2018 operatori ekonomik ankimues "InfoSoft Office" shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë:

"Kriteret e përgjithshme, pika 1.d, operatori ekonomik nuk rezulton të ketë likuiduar të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Nga verifikimi në sistemin e-albania rezulton të ketë detyrime të papaguara për "Tatim mbi fitimin"

II.3.2. Në datën 02.03.2018, operatori ekonomik ankimues "InfoSoft Office" shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentat e përmbledhur si më poshtë:

Arsyeja për të cilën na keni skualifikuar nuk qëndron, ju jeni në shkelje dhe kapërcim të ligjeve më fuqi në republikën e Shqipërisë. Pasi bazuar në ligjin nr. 8438 për tatimet, afati yn për të paguar këtë detyrim është deri më 30 mars, pasi në nenin 30 "Parapagimi" Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarin e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit mbi fitim, brënda datës 30 mars, për muajt janar, shkurt dhe mars; brënda datës 30 qershor, për muajt prill, maj dhe qershor; brënda datës 30 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor. Këstet mund të parapagohen edhe në baza mujore, jo më vonë se data 15 e cdo muaji në shumat si më poshtë:

a) për cdonjërin nga muajt janar, shkurt dhe mars të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën tatimore të dy viteve më parë pjesëtuar me 12;

b) për cdonjërin nga 9 muajt e tjerë të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën paraardhëse tatimore pjestuar me 12.

Bashkangjitur po ju paraqesim edhe faqen e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ku qartësisht shihet që nuk kemi asnjë gjobë apo interes të pa paguar për këtë tatim, gjë që tregon se ky detyrim nuk është maturuar, pra nuk i ka ardhur dhe as nuk i ka kaluar afati për tu paguar (nëse do ti kishte kaluar afati do të fillonte përllogaritja e interesit). Gjithashtu po ju paraqesim edhe vërtetimin e lëshuar nga organet tatimore ditën e sotme, më datë 01.03.2018, pra pasi ju na skualifikuat, ku qartë thuhet që nuk kemi asnjë detyrim të papaguar.

Sa më sipër kërkojmë nxjerrjen e një klasifikimi të ri ku oferta jonë të kualifikohet e rregullt, pasi kemi plotësuar të gjitha kërkesat e kësaj procedure.

II.3.3. Në datën 05.03.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.281/5 prot i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mos pranimin e ankesës.

II.3.4. Në datën 15.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Arsyeja për të cilën na keni skualifikuar nuk qëndron, ju jeni në shkelje dhe kapërcim të ligjeve më fuqi në republikën e Shqipërisë. Pasi bazuar në ligjin nr. 8438 për tatimet, afati yn për të paguar këtë detyrim është deri më 30 mars, pasi në nenin 30 "Parapagimi" Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarin e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit mbi fitim, brënda datës 30 mars, për muajt janar, shkurt dhe mars; brënda datës 30 qershor, për muajt prill, maj dhe qershor; brënda datës 30 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor. Këstet mund të parapagohen edhe në baza mujore, jo më vonë se data 15 e cdo muaji në shumatat si më poshtë:

a) për cdonjërin nga muajt janar, shkurt dhe mars të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën tatimore të dy viteve më parë pjesëtuar me 12;

b) për cdonjërin nga 9 muajt e tjerë të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën paraardhëse tatimore pjesëtuar me 12.

Më datë 30.01.2018 Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka lëshuar një vërtetim ku thuhet që nuk kemi asnjë detyrim të pashlyer, që tregon se kemi shlyer detyrimet për tatimin mbi fitimin të tremujorit të fundit të vitit 2017, brënda datës 30.12.2017, sic përcakton ligji.

Më datë 01.03.2018 Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka lëshuar një vërtetim ku thuhet që nuk kemi asnjë detyrim të pashlyer, përfshi edhe tatimin mbi fitimin, që tregon se detyrimi për tremujorin e parë të vitit 2018 nuk është maturuar akoma, ka afat deri më 30 mars të paguhet dhe nuk mund të konsiderohet detyrim i papaguar.

Po më datë 01.03.2018 në faqen e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve shihet qartë që nuk kemi asnjë gjobë apo interes të papaguar për këtë tatim, gjë që tregon se ky detyrim nuk është maturuar, pra nuk i ka ardhur dhe as nuk i ka kaluar afati për tu paguar (nëse do ti kishte kaluar afati do të fillonte përlllogaritja e interesit).

Tenderi u zhvillua më datë 20.02.2018, pra brënda tremujorit të parë të vitit 2018, datë në të cilën akoma nuk kishim paguar tatimin mbi fitimin, pasi ky detyrim për këtë tremujor paguhet deri në 30 mars 2018.

Në tabelën bashkalidhur shikoni që detyrimi për tremujorin e fundit të vitit 2017 e kemi paguar më 15.12.2017, pra brënda afatit ligjor, dhe detyrimin për tremujorin e parë të vitit 2018 e kemi paguar më 10.03.2018, përsëri brënda afatit ligjor.

Informacioni që gjeneron e-albania ku thuhet që "subjekti rezulton me detyrime të papaguara për tatimin mbi fitimin", i referohemi tatimit të fitimit të tremujorit të parë të vitit 2018. Nëse do të kishim tatime të mëparshme të papaguara, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj nuk do të lëshonte vërtetimin e datës 30.01.2018.

Sa më sipër arsyeja për të cilën jemi skualifikuar nuk qëndron, është në shkelje dhe kapërcim të ligjit për tatimet në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ne kemi plotësuar cdo kërkesë të përcaktuar nga AK, dhe nuk jemi në asnjë nga kushtet e skualifikimit të një oferte sipas përcaktimeve të nenit 45 të LPP-së.

Duke e parë këtë çështje në një këndvështrim më të gjërë, na lind shqetësimi se këtë problem do ta hasim edhe herë të tjera në vazhdim, jo vetëm ne por të gjithë OE që ofertojnë në procedura prokurim, pasi me sa duket sistemi e-albania nxjerr si detyrime të papaguara edhe tatimet që nuk ju është maturuar akoma afati, përfshi këtu tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin në burim, kontributet të sigurimeve shoqërore, shëndetsore, tatim mbi të ardhurat personale. Në muajt prill-maj-qershor do jetë periudha e tremujorit të dytë të tatimit mbi fitimin, dhe tatimi mbi fitimin për

këtë periudhë paguhet deri më 30 qershor. Gjatë këtyre 3 muajve sistemi e-albania do të na nxjerri si kompani me detyrime të papaguara. Në këto kushte kërkojmë një interpretim tuajin. Sa më sipër kërkojmë nxjerrjen e një klasifikimi të ri ku oferta jonë të kualifikohet e rregullt, pasi kemi plotësuar të gjitha kërkesat e kësaj procedure.

II.4. Me shkresën nr. 333/2 prot, datë 26.03.2018, protokolluar me tonën me anë të shkresën nr.503/2 prot, datë 27.03.2018, me objekt “Dërgim informacioni”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se “Arsyeja për të cilën na keni skualifikuar nuk qëndron, ju jeni në shkelje dhe kapërcim të ligjeve më fuqi në republikën e Shqipërisë. Pasi bazuar në ligjin nr. 8438 për tatimet, afati yn për të paguar këtë detyrim është deri më 30 mars, pasi në nenin 30 “Parapagimi” Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarin e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit mbi fitim, brënda datës 30 mars, për muajt janar, shkurt dhe mars; brënda datës 30 qershor, për muajt prill, maj dhe qershor; brënda datës 30 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor. Këstet mund të parapagohen edhe në baza mujore, jo më vonë se data 15 e cdo muaji në shumat si më poshtë:

a) për cdonjërin nga muajt janar, shkurt dhe mars të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën tatimore të dy viteve më parë pjesëtuar me 12;

b) për cdonjërin nga 9 muajt e tjerë të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën paraardhëse tatimore pjesëtuar me 12”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 8/1 “Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit”, gërma d) të dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi përcaktohet se:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a)

b)

c)

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

II.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

“InfoSoft Office” shpk

“Declaratë mbi përmbushjen e Kriereve të Përgjithshme”, që mban datën 20.02.2018, e firmosur nga administratori i shoqërisë dhe që mban vulën identifikuese të shoqërisë në fjalë.

III.1.3. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 15 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes”, përcaktohet se:

“Përmbushja e kriereve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit.

Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme”.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, rashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;

Në nenin 53, pika 3 të LPP-së parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.5. Në nenin 45, pika 2, gërmat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur:

d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës”.

III.1.5. Në nenin 16 pika 1 “Fusha e veprimit të tatimit mbi fitimin”, Kreu III “Tatim mbi Fitimin”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, parashikohet se: Tatimit mbi fitimin i nënshtrohen këta persona:

a) Personat juridikë dhe ortakëritë e parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të nenit 2 këtij ligji dhe që janë regjistruar për TVSH-në.

b) Personat juridikë, ortakëritë të parashikuara në nënparagrafet “iii” dhe “iv” të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 2 dhe që janë të rregjistruar për TVSH-në e tjera të personave të themeluara ose të organizuara në bazë të një ligji të huaj dhe që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) Çdo person tjetër, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur ky është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, me përjashtim të rastit kur ky person është subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël.

III.1.6. Në nenin 19 “Fitimi i tatueshëm”, Kreu III “Tatim mbi Fitimin”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, parashikohet se:

“Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim”.

III.1.7. Në nenin 29 “Deklarimi tatimor dhe llogaritja perfundimtare e detyrimit”, Kreu III “Tatim mbi Fitimin”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, parashikohet se:

1) Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrisë te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke paraqitur ne te njejten kohe bilancin kontabel, se bashku me anekset e tij, si dhe çdo te dhene tjeter te percaktuar ne udhezimin e Ministrisë te Financave ne zbatim te ketij ligji. Per efekte fiskale, te dhenat e dokumenteve te mesiperme quhen te pranuar, kur miratohen nga administrata tatimore ose kur kalojne dy muaj pas dorezimit te tyre zyrtar dhe administrata tatimore nuk pergjigjet zyrtarisht.

2) Tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, pakësuar me shumat e përcaktuara sipas nenit 37 te ketij ligji dhe me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, ne çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme.

III.1.8. Në nenin 30 “Parapagimi”, pika 1, Kreu III “Tatim mbi Fitimin”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, parashikohet se:

Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit mbi fitimin, brenda datës 30 mars, për muajt janar, shkurt dhe mars; brenda datës 30 qershor, për muajt prill, maj dhe qershor; brenda dates 30 shtator, për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe, brenda datës 30 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor. Këstet mund të paguhen edhe në baza mujore, jo më vonë se data 15 e çdo muaji, në shumat si më poshtë:

- a) për çdonjërin nga muajt janar, shkurt dhe mars të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën tatimore të dy viteve më parë pjesëtuar me 12;*
- b) për çdonjërin nga 9 muajt e tjerë të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën paraardhëse tatimore pjesëtuar me 12.*

III.1.9. Në pikën 3.13.1 të udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, parashikohet se:

3.13.1 Afatet e pagesë së kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin Tatimi mbi fitimin paguhet çdo tremujor ose çdo muaj në formë paradhënie gjatë vitit, bazuar në këste mujore. Administrata tatimore, bazuar në të dhënat e deklaratës së fitimit të tatueshëm të vitit paraardhës, dorëzuar nga tatimpaguesi brenda datës 31 mars të vitit vijues, llogarit këstet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin për periudhën prill – dhjetor të vitit vijues dhe për periudhën janar – mars të vitit të ardhshëm. Këstet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin, për periudhën prill – dhjetor të vitit vijues dhe për periudhën janar – mars të vitit të ardhshëm, i njoftohen tatimpaguesit brenda datës 30 prill të çdo viti. Këstet e paradhënieve të tatimit mbi fitimin, përcaktuar si më sipër paguhen nga tatimpaguesit në bazë tremujore ose në bazë mujore.

- a) Kur këstet e paradhënieve të tatimit mbi fitimin paguhen në bazë tremujore, kësti i çdo tremujori llogaritet në bazë të shumës së kësteve të çdo muaji të tremujorit. Afatet e pagesës së kësteve tremujore të paradhënieve janë:*
 - i) për tremujorin e parë (janar-shkurt-mars) të vitit, brenda datës 30 mars;*
 - ii) për tremujorin e dytë (prill-maj-qershor) të vitit, brenda datës 30 qershor;*
 - iii) për tremujorin e tretë (korrik-gusht-shtator) të vitit, brenda datës 30 shtator;*
 - iv) për tremujorin e katërt (tetor-nëntor-dhjetor) brenda datës 30 dhjetor.*
- b) Kur këstet e paradhënieve të tatimit mbi fitimin paguhen në bazë mujore, afati i pagesës është brenda datës 15 të çdo muaji.*

III.1.10. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.11. Referuar sa më sipër Komisioni konstaton se për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit parashikuar në shtojcën 8/1, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë që të plotësojnë dhe dorëzojnë shtojcën 5 vetëdeklaratën me shkrim të subjektit për plotësimin e kriterëve të parashikuar në shtojcën 8/1 të dokumentave të tenderit. KPP

konstaton se operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojcën 5 “Deklaratë mbi Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme”, për të cilat autoriteti kontraktor pretendon se ka detyrime tatimore të palikuiduara, pasi nga verifikimi i bërë nga ana e autoritetit kontraktor në sistemin e-albania rezulton se subjekti “InfoSoft Office” shpk të ketë detyrime të papaguara për “Tatim mbi Fitim”.

III.1.12. KPP referuar bazës ligjore të sipërcituar konstaton se në ligjin “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, në Kreu III “Tatim mbi Fitimin” nenin 30 “Parapagimi”, pika 1, parashikon shprehimisht se *tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit mbi fitimin, brenda datës 30 mars, për muajt janar, shkurt dhe mars; brenda datës 30 qershor, për muajt prill, maj dhe qershor; brenda dates 30 shtator, për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe, brenda datës 30 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor.* Në rastin konkret KPP, referuar dhe datës së dorzimit të ofertave nga operatorët ekonomik për procedurën e prokurimit objekt ankimi e cila mban datën 20.02.2018, konstaton se në zbatim të referencës ligjore të mësipërcituar operatori ekonomik ankimues nuk ndodhet përpara kushtit të mos përmbushjes së shtojcës 8/1, gërma (d) parashikuar në dokumentat standarte të tenderit dhe pretenduar nga autoriteti kontraktorë, pasi në dispozitat e sipërcituara janë parashikuar shprehimisht afatet e pagesës së tatimit mbi fitim nga tatimpaguesit në llogari të organeve tatimore. KPP konstaton se vetë ligji “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, në Kreu III “Tatim mbi Fitimin” në nenin 30 “Parapagimi”, pika 1, nuk ka parashikuar afate strikte/shteruese për shlyerjen e detyrime për tatim fitimin nga tatimpaguesit. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk mund të kushtëzojë operatorët ekonomikë të paguajnë një detyrim për të cilin mund të kenë ende afat për ta paguar në një moment të dytë duke qenë se vetë autoriteti kontraktor nuk provon se afati për shlyerjen e tyre ka përfunduar për shkak të parashikimeve ligjore. KPP gjykon se operatori ekonomikë “InfoSoft Office” shpk ka dorëzuar dokumentacion të rregullt duke përmbushur në mënyrë rigorozë kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të pranimit / kualifikimit të parashikuara në dokumentat e tenderit objekt ankimi.

Në balancën mes përpjekjes për të siguruar *pagesën e plotë të të gjithë elementëve të detyrimit tatimor, nga njëra anë, dhe mirpërdorimin e fondeve publike* – që arrihet përpara së gjithash përmes një pjesmarrje të gjerë e konkurruese të operatorëve ekonomikë, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ato raste kur nga operatori pjesmarrës në procedurën e prokurimit është paguar tatimi përkatës apo edhe nëse ai nuk është paguar por vetë dispozitat ligjore që rregullojnë pagesat e detyrimeve tatimore parashikojnë afate për pagimin e tyre, afate këto të cilat nuk janë shkelur nga subjektet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor nuk duhet ta skualifikojë këtë operator në lidhje me mospërmbushje të detyrimeve tatimore. Pasi për më tepër që KPP vëren se, nga dokumentacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor së bashku me dokumentacionin që i referohet operatori ekonomik ankimues, rezulton se në vërtetimin e – albania me nr. T00149489, datë 26.02.2018 thuhet se në mënyrë përgjithsuese se “*sipas sistemit tonë informatik subjekti “InfoSoft Office” shpk është me përgjegjësi tatimore për Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, Tatim i Mbajtur në Burim, Tatim mbi fitim, Tatim mbi të Ardhurat nga Punësimi*”, pa përcaktuar se për ciliën nga këto kategori ky subjekt është me përgjegjësi tatimore, pasi për secilën kategori ligji specifik ka parashikuar për tatimpaguesit edhe afate për shlyerjen e detyrimeve tatimore, ndërsa

në informacionin e autoritetit kontraktor bashkangjitur të cilit ndodhet edhe “Vërtetimi me nr 1572 prot, datë 01.03.2018, lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve rezulton se për periudhën deri më datën 01.03.2018 tatimpaguesi “InfoSoft Office” shpk, nuk ka detyrime tatimore për Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Tatim mbi Fitimin, Tatim në Burim, Kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, Tatim mbi të Ardhurat nga Personale”. K.P.P. gjykon se nuk ndodhemi në situatën e sipërcituar pasi operatori ekonomik ankimues rezulton se nuk ka detyrime tatimore të pashlyera. Në rastin konkret vërtetimi i lëshuar nga organi kompetent Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesëve të Mëdhenj, nuk jep asnjë të dhëna që ky subjekt ka detyrim tatimor, interes apo dhe gjobë.

Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, skualifikimi prej autoritetit kontraktor i një operatori ekonomik pjesmarrës në një procedurë prokurimi me argumentin se “ka detyrime tatimore të pashlyera”, kur vetë ligjvënësi për këto të fundit ka parashikuar afate ligjore për shlyerjen e tyre (detyrimeve tatimore) nuk është i drejtë dhe tërësisht në përputhje me frymën dhe parashikimet ligjore të LPP.

Përsa më sipër në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF- 42437-01-26-2018, me objekt “Blerje mjete didaktike dhe kancelarike në funksion të projektit “Bëjmë detyrat e shtëpisë” dhe mjete kancelarike për nevojat e QEZHEF” me fond limit 2.004.271 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 20.02.2018 nga autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anullopë vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 503 Protokoll; Datë 15.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha